

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA, A.D.



BULETINI

Buletini nr.11 • Viti IX, 2016

Inaugurohet projekti i rregullimit sekondar Kosovë-Shqipëri si dhe përfundimi i punimeve në linjën interkonektive 400 kV deri në kufirin me Shqipërinë

Nënshkruhet Marrëveshja për Kyçe të Sistemit Energjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale, në mes të KOSTT dhe ENTSO-E

PËRMBAJTJA

- Inaugurohet projekti i rregullimit sekondar Kosovë-Shqipëri si dhe përfundimi i punimeve në linjën interkonektive 400 kV deri në kufirin me Shqipërinë 3
- Emërohet Kryeshefi Ekzekutiv i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a 5
- Delegacioni i lartë i Ambasadës Gjermane vizitoi KOSTT-in 5
- Nënshkruhet Marrëveshja për Kyçje të Sistemit Energjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale, në mes të KOSTT dhe ENTSO-E 6
- Qeveria e Republikës së Kosovës emëron Bordin e Drejtorëve të KOSTT sh.a 7
- Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Hasani priti në takim drejtoreshën e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor znj.Ellen Goldstein 7
- Realizohet vizitë inspektuese punimeve në linjën ndërshtetërore Kosovë-Shqipëri 8
- Përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe të USAID vizituan KOSTT-in 8
- KOSTT përkrah komunitetin e tetë Komunave të Kosovës 9
- KOSTT dhe KfW zotohen për avancim të mëtutjeshëm të bashkëpunimit 10
- KOSTT analizon mundësitë e komercializimit të kapaciteteve të lira të fibrave optik OPGW 11
- Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë 12

Buletini nr.11, Viti IX, 2016

Buletini është publikim i KOSTT sh.a,

Rr. Iljaz Kodra p.n, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381(0) 38 501 301 174 ; email: info@kostt.com

Web: www.kostt.com

Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:

Zyrën për Komunikim dhe Relacione me Publikun në:

zana.rama@kostt.com ose info@kostt.com

Inaugurohet projekti i rregullimit sekondar Kosovë-Shqipëri si dhe përfundimi i punimeve në linjën interkonektive 400 kV deri në kufirin me Shqipërinë

Me 17 Dhjetor 2015, në praninë e delegacionit të lartë Qeveritar të Republikës së Kosovës, përfaqësuesve të Qeverisë së Shqipërisë, të Ambasadës Gjermane në Kosovë, Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare u inaugurua projekti **“Rregullimi Sekondar Frekuencë/Fuqi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë si dhe përfundimi i punimeve në linjën interkonektive 400 kV deri në kufirin me Shqipëri.”**



Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani theksoi “këto projekte janë ndër më të rëndësishmet dhe nga më të mëdhatë e pasluftës në Kosovë. Përfundimi me sukses dhe brenda afateve i këtyre dy projekteve krijon parakushtet dhe përforcon rrjetin e transmisionit për zhvillimet tjera në këtë sektorë e në veçanti e gjen KOSTT-in të përgatitur për të pritur investimet në kapacitetet e reja gjeneruese si dhe avancon pozitën tonë në rrjetin rajonal të transmisioneve. Duke folur për rëndësinë e përfundimit të punimeve në linjën 400 kV Kosovë-Shqipëri, Kryeministri i Kosovës z.Isa Mustafa theksoi “E konsideroj që është një sukses i ynë i përbashkët i cili do të mundësoj optimizimin e këtyre dy sistemeve jo vetëm në ngritjen e sistemeve transmetuese por edhe në ngritjen e

besueshmërisë së ekonomisë dhe qytetarëve tanë për tu furnizuar në mënyrë të rregullt me energji elektrike”.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik z.Blerand Stavileci theksoi që “realizimi i këtij projekti përbën një kapitull të ri në sektorin energjetik të vendit tonë, një kapitull që do ta transformojmë për ta bërë gati për zhvillimet e ardhshme. Ne po bëjmë hapa progresiv për të përmbushur agjendën evropiane në sektorin e energjisë.”

Projekti i ndërtimit të linjës së tensionit të lartë 400 kV Kosovë-Shqipëri, i cili u inaugurua me 17 dhjetor ka qenë i përbërë nga dy LOT-e. LOT 1 i cili ka përfshi ndërtimin e linjës interkonektive që lidhë nënstationet NS Kosova B (Kosovë) dhe NS Tirana 2 (Shqipëri) më një gjatësi në pjesën e Kosovës prej 91 km dhe gjatësi totale prej 241.5 km. Ndërsa LOT 2 ka përfshi ndërtimin dhe instalimin e pajisjeve të tensionit të lartë në këto nënstatione, si dhe infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të rregullimit sekondar (frekuencë – fuqi), në mes të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Shqipërisë (OST).

Ndërtimi i linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri, do të forcoj rolin e Kosovës në rajon si një nyje e rëndësishme e cila akomodon transitin dhe i kontribuon sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit rajonal energjetik. Në anën tjetër projekti i Rregullimit sekondar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë shenon një epokë të re për KOSTT-in si operator i transmisionit të energjisë elektrike sepse me këtë shkëputet nga varësia e Sistemit Elektroenergjetik të Serbisë.

Përfaqësuesja e Ambasadës Gjermane në Kosovë znj. Henriette Kotter në ceremoninë inauguruese theksoi që "përkrahja financiare gjermane për rrjetin e transmisionit do të ndihmojë në integrimin e rrjetit të Kosovës në rrjetin rajonal të transmisioneve të energjisë elektrike". Ndërsa në anën tjetër drejtoresha e KfW në Kosovë znj. Esther Gravenkoetter duke e vlerësuar lartë KOSTT-in si kompani të suksesshme ka theksuar që "ky projekt i financuar nga KfW ka qenë më i rëndësishmi në Kosovë dhe ky projekt shumë i suksesshëm është mundësuar falë bashkëpunimit të shkëlqyer të bazuar në besim, profesionalizëm dhe transparencë."



Në anën tjetër, zv.ministri i Energjetikës dhe Industrisë së Shqipërisë z.Illir Bejtja tha se "me linjën interkonketive ecim së bashku një hap përpara me sistemet energjetike për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe në të njëjtën kohë për t'i parapri në mënyrë ekonomike bashkimeve politike të të dy vendeve brenda hapësirës evropiane".

Financimi i projektit për pjesën e Kosovës është bërë nga Qeveria Gjermane bazuar në Marrëveshjen e Financimit që është nënshkruar në mes të KfW, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (Qeveria e Kosovës) dhe KOSTT, për hua dhe kontribut financiar në vlerën e përgjithshme prej 33.5 milion Euro, nga e cila €16.5 milion grant + €17 milion kredi. Ngjashëm, Qeveria Gjermane nëpërmjet KfW gjithashtu ka financuar pjesën e

linjës në anën e Republikës së Shqipërisë. Ndërtimi i linjës interkonketive të tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri do të ndikojë në optimizimin e dy sistemeve, ngritjen e kapaciteteve transmetuese, si dhe ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve elektroenergjetike të Kosovës dhe Shqipërisë, dhe po ashtu do të ndikojë në zhvillimin e tregut të të dy vendeve si dhe tregut rajonal të energjisë elektrike. Me implementimin e projektit të Autostradës Energjetike Kosovë-Shqipëri, do të mundësohet shkëmbimi më i madh i energjisë elektrike në mes të dy vendeve sidomos pas ngritjes së kapaciteteve gjeneruese të planifikuara në Kosovë të bazuara kryesisht në linjit si dhe të kapaciteteve gjeneruese hidro të Republikës së Shqipërisë. Derisa Kosova dhe Shqipëria aktualisht janë të lidhura me një linjë interkonketive 220kV, kapaciteti i transferit të interkonkesionit me Shqipëri nga aktualisht rreth 200MW, me vënjen në operim të këtij projekti së bashku me linjën 400kV Tirana –Podgoricë do të ngritet në rreth 900MW.

Projekti për ndërtimin e linjës interkonketive Kosovë-Shqipëri ka përfunduar 2 muaj para afatit kontraktual, implementimi i LOT 1 është realizuar nga kompania kroate Dalekovod ndërsa implementimi i LOT 2 nga kompania gjermane ABB.



Në kuadër të ceremonisë u firmos edhe kontrata tregtare për Rregullim Sekondar në mes të KOSTT dhe OST Shqipëri.

Emërohet Kryeshefi Ekzekutiv i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a

Pas një procesi transparent dhe konkurrues në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, në muajin dhjetor 2015 Bordi i Drejtorëve të KOSTT sh.a në mënyrë unanime ka vendosur që të emëroj Kryeshef Ekzekutiv të KOSTT sh.a z.Mustafë Hasani. z.Mustafë Hasani me profesion Magjistër i Shkencave të Administrimit të Biznesit mban përvojë shumë vjeçare në pozita të larta menaxheriale si Drejtor Gjeneral në Administratën Tatimore të Kosovës, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencionit për Promovimin e Investimeve, Drejtor i Bordit të Trafikut Urban, angazhime në projekte të ndryshme të Komisionit Evropian dhe së fundi drejtor i Departmentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat në Ministrinë e Financave. z.Hasani



gjithashtu është ligjerues i lëndëve ekonomike në kolegje private në Kosovë.

z.Mustafë Hasani ka marrë udhëheqjen e KOSTT pas pensionimit të z.Naim Bejtullahu.

Delegacioni i lartë i Ambasadës Gjermane vizitoi KOSTT-in

Gjatë muajit janar 2016, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani ka pritur në takim zv.Ambasadoren e RF të Gjermanisë znj.Christina Gehlsen e shoqëruar nga Sekretarja e Parë e Ambasadës Gjermane znj.Henriette Koetter. Me këtë rast, z.Hasani ka falënderuar znj.Gehlsen për mbështetjen e vazhdueshme që ka marrë KOSTT nga Republika Federale e Gjermanisë si dhe është shprehur i bindur që ky bashkëpunim i frytshëm do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Në takim, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Hasani njoftoi zv.Ambasadoren Gehlsen me zhvillimet aktuale dhe sfidat në implementimin e Marrëveshjes për Kyçje me ENTSO-E, si dhe implikimet që ka në zhvillimin e sektorit të energjisë si dhe në hapjen dhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

Po ashtu, përfaqësuesit e Ambasadës Gjermane u njoftuan në lidhje me kapacitetet e Rrjetit



Transmetues për të mundësuar kyçjen e kapaciteteve të reja gjeneruese duke përfshirë burimet e renovueshme të energjisë elektrike.

Në anën e saj, zv.Ambasadorka Gehlsen ka shprehur interesimin e Qeverisë Gjermane për vazhdimin e bashkëpunimit dhe përkrahjes së sektorit rajonal të energjisë si një nga shtyllat zhvillimore ekonomike, me fokus të veçantë mbështetjen e zhvillimit të Rrjetit Transmetues të energjisë elektrike.

Nënshkruhet Marrëveshja për Kyçje të Sistemit Energjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale, në mes të KOSTT dhe ENTSO-E

Në ambientet e organizatës së Operatorëve Evropian të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) në Bruksel, me 1 Tetor 2015 u nënshkrua Marrëveshja për Kyçje të Sistemit Energjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale. Marrëveshja është nënshkruar në mes të KOSTT, si Operator i Sistemit të Transmisionit (OST) të Kosovës në një rën anë dhe ENTSO-E në anën tjetër e përfaqësuar nga 30 OST të Grupit Regjional të Evropës Kontinentale.

Pas Marrëveshjeve për Operim (Inter-TSO Agreement) që KOSTT nënshkroi me të gjitha OST-të e shteteve fqinje (Shqipëri, Mali i Zi, Serbi dhe Maqedoni) në vitin e kaluar, ekspertët e KOSTT në krye me menaxhmentin si dhe në bashkëpunim me grupin punues të ENTSO-E, kanë punuar për krijimin e kushteve teknike për nënshkrimin e Marrëveshjes për Kyçje ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Kyçje, KOSTT bëhet zonë/bllok kontrollues i pavarur në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale. Përveç operimit të sistemit si bllok kontrollues do të bëhet edhe menaxhimi komercial i kongjestionëve në linjat interkonektive të Kosovës, alokimi i kapaciteteve interkonektive (linjat ndërshtetërore), do të realizohen të hyrat nga tranziti i energjisë elektrike nëpër rrjetin

transmetues të Kosovës si dhe për humbjet në rrjetin horizontal të transmetimit të energjisë elektrike, çështje të cilat kanë qenë të hapura tashmë disa vite. Përfundimisht ky proces do të rezultojë me përfitim edhe për konsumatorët e energjisë elektrike të Kosovës dhe industrinë e energjisë elektrike si dhe do të ketë edhe obligime që ndërlidhen me sjelljen e sistemit në përputhje me modin e ri të operimit.

Në kuadër të këtij procesi, KOSTT brenda 2 viteve do të vazhdojë të punojë për implementimin e masave teknike për të përmbushur të gjitha standardet teknike të Manualit të Operimit. Manuali i Operimit definon parimet dhe rregullat teknike për operimin e rrjeteve interkonektive të energjisë elektrike në kuadër të ENTSO-E. Pas kësaj periudhe, KOSTT-it i mundësohet nënshkrimi i Marrëveshjes së Përhershme e cila do të pasojë me anëtarësimin e plotë në këtë organizatë ndërkombëtare.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Kyçje, pritet që brenda 2 muajve KOSTT të fillojë operimin e pavarur të Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Kosovës dhe, edhe në baza legale dhe komerciale të operoj Sistemin e Transmisionit të Kosovës sinkron me Sistemin Evropian të Transmetimit të energjisë elektrike.



Qeveria e Republikës së Kosovës emëron Bordin e Drejtorëve të KOSTT sh.a



Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 2 shtator 2015 ka emëruar Bordin e Drejtorëve të KOSTT sh.a në përbërje të: znj. Drita Konxheli-Kryesuese, z. Afrim Prekazi, z. Musa Misini, znj. Anita Cucoviq, z. Nebih Zariqi dhe z. Gani Jashari.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Hasani priti në takim drejtoreshën e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor znj. Ellen Goldstein

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani, gjatë muajit janar priti në takim drejtoreshën e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor znj. Ellen Goldstein me bashkëpunëtorë.



Në këtë takim u diskutua rreth infrastrukturës ekzistuese teknike dhe ligjore të Sistemit Transmetues të Republikës së Kosovës dhe mundësive për të akomoduar kyçjen e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike në Sistem.

Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Hasani njoftoi drejtoreshën e Bankës Botërore znj. Goldstein mbi gjendjen aktuale të Rrjetit Transmetues të Kosovës i cili është i lidhur fuqimisht me linja interkonektive (ndërkufitare) me të gjitha shtetet fqinje si dhe është i kyçur në zonën sinkrone të Evropës Kontinentale. z. Hasani theksoi që funksionimi i Sistemit të Transmisionit është stabil dhe në bazë të analizave teknike që janë realizuar, kyçja e gjeneratorit të ri të planifikuar të energjisë elektrike në sistem, do të akomodohej pa ndonjë vështirësi si nga aspekti teknik ashtu edhe nga ai ligjor. Të gjitha aktet nënligjore dhe procedurale për kyçje në Sistemin Transmetues, KOSTT i ka të zhvilluara dhe tashmë janë në funksion.

Gjatë këtij takimi u bisedua gjithashtu edhe për mbështetjen me ekspertizë që e ka ofruar Banka Botërore për KOSTT-in për gjetjen e mënyrës më të mirë të shfrytëzimit të kapaciteteve të fibrës optik, meqenëse ekziston një infrastrukturë telekomunikuese mjaft e zhvilluar në KOSTT.

Realizohet vizitë inspektuese punimeve në linjën ndërshtetërore Kosovë-Shqipëri

Në shtator 2015, delegacioni i përbashkët i zyrtarëve të lartë të Qeverisë së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë, kanë realizuar një vizitë inspektuese punimeve për ndërtimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri ku ishte prezente edhe Dr.Ingrid Hengster, anëtare e Bordit të Drejtorëve të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW). Të pranishmit u njoftuan me progresin e punimeve në implementimin e projektit si dhe patën rastin që të shohin procesin e shtrirjes së përçuesve elektrik në shtyllat elektrike nr. 1 dhe nr. 2.



Me këtë rast, gjithashtu u nënshkrua edhe kontrata në mes të KOSTT dhe kompanisë austriake SIEMENS e cila do të implementoj punimet në kuadër të LOT-it 4 që janë pjesë e Projektit "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit,

Programi IV dhe V i Sektorit". Vlera e kontratës prej 8,722,018 Euro bashkë-financohet nga KfW dhe KOSTT. Projekti parasheh rehabilitimin e 19 Nënstacioneve të Operator Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT).

Përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe të USAID vizituan KOSTT-in

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim zyrtarin e lartë për ekonomi të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë z.Tod Christiansen si dhe përfaqësuesit e Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) z. Scott Cameron, drejtor i zyrës për rritje ekonomike dhe z.Arben Nagavci specialist për menaxhim të projekteve.

Në takim u diskutua për përkrahjen në sektorin e energjisë në Kosovë, respektivisht rreth progresit të projektit të USAID (RePower) në sektorin e enegjisë ku përfshihet edhe KOSTT. Përmes konsulencës Repower është duke u realizuar studimi mbi "Benefitet e tregut të përbashkët energjetik Kosovë-Shqipëri", mundësitë që Kosova (KOSTT) të jenë pjesë e berzës së energjisë (Power Exchange) që është duke u krijuar në Shqipëri, si dhe mundësinë e ofrimit të praktikës gjasthtë mujore në KOSTT për studentët e lëmive përkatëse, me interes për KOSTT-in.

z.Hasani njoftoi gjithashtu delegacionin amerikan me gjendjen aktuale të Rrjetit Transmetues të Kosovës si dhe mundësitë dhe sfidat për të akomoduar kyçjen e kapaciteteve të reja gjeneruese në Sistem. Gjithashtu,

është diskutuar për sfidat me të cilat po përballet KOSTT në implementimin e Marrëveshjes për Kyçje me organizatën e Operatorëve Evropian të Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike (ENTSO-E).



Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani, me këtë rast shprehu falënderimin e tij për përkrahjen e Qeverisë Amerikane për zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit të energjisë në Kosovë. Në anën tjetër, delegacioni amerikan e cilësoi të rëndësishëm bashkëpunimin me KOSTT si dhe shprehu gatishmërinë për përkrahjen e mëtutjeshme të KOSTT si pjesë e sektorit të energjisë elektrike në Kosovë.

KOSTT përkrah komunitetin e tetë Komunave të Kosovës

KOSTT edhe më tutje vazhdon me angazhimet në fushën e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave (Corporate Social Responsibility) të cilën e konsideron si një proces përmes së cilës kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm fillimisht përmes mënyrës se si operon duke inkorporuar politikën e biznesit të përgjegjshëm në politikën e brendshme të kompanisë, ushtrimin të veprimtarisë së vet për të siguruar funksionimin e sigurtë dhe të besueshëm të Sistemit të Transmisionit, kujdesin ndaj mjedisit, funksionimin në përputhje me politikën e qeverisjes korporative, kujdesin për zhvillimin dhe trajnimin e punonjësve, ndërkaq theks të veçantë i vë sigurisë në punë gjë që është esenciale për një kompani që ka të bëjë me energji elektrike të tensionit të lartë. Gjatë vitit 2015 KOSTT ka vazhduar aktivitetet përmes rrjetit të bizneseve të përgjegjshme Kosovo CSR Network si dhe ka implementuar disa aktivitete të rëndësishme në këtë drejtim.

Në kuadër të projektit për ndërtimin e linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri KOSTT ka implementuar projektin më të madhë të CSR duke përkrahur komunitetin e 8 komunave përgjatë së cilave shtrihet traseja e linjës ndërshtetërore 400 kV Kosovë-Shqipëri, përkatësisht komunat: Kastriot, Vushtrri, Drenas, Malishevë, Rahovec, Gjakovë, Deçan dhe Junik.

Projekti ka pasur të bëjë me përkrahjen e drejtpërdrejtë të komunitetit që jeton pikërisht në vendbanimet nga shtrihet linja e re ndërshtetërore. Përkrahja është realizuar në këto projekte:



Komuna e Deçanit

Ndërtimi i infrastrukturës së kanalizimit në Shkollën fillore "Dëshmorët e Baballoqit", Baballoq, z.k. Gramaçel

Komuna e Drenasit

Rregullimi i rrethojës së SHMU "Abedin Bujupi", fshati Gjurgjicë, z.k. Arllat,

Komuna e Rahovecit

Rregullimi i terrenit sportiv në SHFMU "Milaim Krasniqi", fshati Pastasel

Komuna e Gjakovës

Rregullimi i nyjeve sanitare në shkollën fillore "Shtjefën Kurti", fshati Novosellë e Epërme



Komuna Malishevë

Rregullimi i oborrit të shkollës fillore "Tafil Kelmendi", fshati Balincë

Komuna Vushtrri

Ndërtimi i pikave pritëse për autobusë në rrugët lokale të fshatrave nga kalon linja

Komuna Junik

Hapja dhe instalimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen Kallavaj

Komuna Obiliq

Ndriqimi publik i rrugëve në fshatin Milloshevë

Një projekt tjetër i KOSTT i cili gjithashtu ndërlidhet me linjën e re ndërshtetërore Kosovë-Shqipëri është projekti "Sistemet e dyfishta të MAK-Duplex Sistemet -

Linja 400 kV Kosovë-Shqipëri", përmes së cilit KOSTT ka filluar aplikimin e teknologjisë më të avancuar që aplikohet në Botë për mbrojtje nga korrozioni (MAK) e cila përveç mbrojtjes së dyfishtë të konstruksioneve metalike me sistemin "Duplex" gjithashtu përmban një element tjetër të rëndësishëm mjedisor-eliminimin e ndikimit negativ vizuel të aktiviteteve të KOSTT duke përshtatur ngjyrat e shtyllave elektrike me karakteristikat e peisazhit. KOSTT ka implementuar këtë iniciativë në 20 km e para të linjës në fjalë, përkatësisht 54 shtylla elektrike. Ky projekt do të shërbej për promovimin e mbrojtjes së ambientit dhe kontribuimit në përmirësimin e pamjes estetike të pajisjeve dhe mjeteve "të egra" metalike duke i përshtatur ato me natyrën.

KOSTT dhe KfW zotohen për avancim të mëtutjeshëm të bashkëpunimit

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani ka realizuar një takim pune me drejtoreshën për Kosovë të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) znj. Esther Gravenkoetter. Në takim u diskutua rreth progresit të implementimit të projekteve të KOSTT që financohen nga Banka Gjermane për Zhvillim si dhe rreth bashkëpunimit të mëtutjeshëm në mes të dy institucioneve.



Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani ka shprehur interesimin për avansimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit me KfW si një nga partnerët kryesorë në zhvillimin e Sistemit Transmetues të Republikës së Kosovës. Në anën tjetër, znj. Gravenkoetter njoftoi z. Hasani se sektori i energjisë mbetet sektori primarë i orientimit të fondeve të KfW,

me ç'rast deri më tani 70% e investimeve ka qenë në këtë sektorë dhe, njëherit shprehu gatishmërinë për të mbështetur KOSTT-in për projekte të reja në funksion të zhvillimit të mëtutjeshëm të Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë.



Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani, duke e falënderuar për bashkëpunimin e gjertanishëm, me këtë rast i dorëzoi një mirënjohje znj. Gravenkoetter për kontributin financiar të KfW në implementimin e projekteve e në veçanti të projektit për ndërtimin e linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri.

KOSTT analizon mundësitë e komercializimit të kapaciteteve të lira të fibrave optik OPGW

S sektori i Telekomunikacionit, duke përfshirë të gjithë gamën e shërbimeve komunikuese dhe të informacionit, është njëri nga sektorët shërbyes më të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, ndërkohë që kërkesat për shumëllojshmëri dhe shërbimeve moderne telekomunikuese, vlerësohet të jenë vazhdimisht në rritje e sipër.

Përmbushja e këtyre kërkesave, në bazë të studimeve të bëra, të bazuara në praktikën e disa vendeve në regjionin si dhe në Europë, nuk mund të arrihet në mënyrë efektive, pa shfrytëzimin e përbashkët të kapaciteteve të fijeve optike të cilat i posedojnë kompanitë publike, në mesin e të cilave ndodhet edhe KOSTT.

Këto konstatime bazohen në faktin se KOSTT, në disa vite të fundit, ka ndërtuar dhe zhvilluar rrjetin e ri telekomunikues të bazuar në kabllo OPGW (Optical Power Ground Wire), të vendosur nëpër largpërçues të tensionit të lartë, brenda gypave në bërthamën e të cilëve janë të vendosur nga 24 apo 48 fije optike.

Ky rrjet ka një gjatësi mbi 1100 km, dhe është i shpërndarë në të gjithë territorin e Kosovës, me një infrastrukturë të organizuar në një topologji me katër unaza SDH, redundante dhe të ndërthurura në mes veti për të plotësuar kërkesat funksionale dhe operacionale për Operim me Sistemin e Transmisionit të KOSTT.

Kërkesat funksionale dhe operacionale, kanë të bëjnë kryesisht me komunikime me zë dhe me të dhëna, për të mundësuar realizimin e bisedave telefonike dhe funksionimin e nënsistemeve si: SCADA/EMS, Matjet e Tensionit të Lartë, Mbrojtje nga distanca, rrjeti LAN/WAN dhe për komunikime interTSO.

Në bazë të studimeve të më hershme, është llogaritur që një kabëll tipik optik me 48 fije optike, mund të sigurojë minimum 120 Gbps kapacitet të bartjes së të dhënave. Gjithashtu, asokohe është

llogaritur se Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës nuk kërkon më shumë se maksimalisht 20 deri në 30 Gbps kapacitet (8 deri 12 fije optike).

Në bazë të kësaj dhe duke patur parasysh aspektin kohorë, lehtë mund të shihet se së paku 60 Gbps (12 deri në 24 fije optike) mund të komercializohen nga ana e KOSTT.

Bazuar në këto të dhëna dhe me qëllim të lehtësimit të shfrytëzimit të përbashkët të rrjeteve me fibra optike në Kosovë, Banka Botërore ka ofruar një pako mbështetje teknike për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) të Kosovës dhe KOSTT-in, në kuadër të një granti nga Ndërmarrja Këshilluese për Infrastrukturë Publike-Private (PPIAF). Komponentë kryesore e kësaj mbështetje konsultuese teknike, për KOSTT-in është:

Mbështetja në "Operacionalizimin e shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës telekomunikuese të KOSTT-it", me anë të së cilës është hartuar modeli i kostos në bazë të analizës sensitive për vlerësimin e kostove për rastin e dhënies në shfrytëzim (me qira) të fijeve optike.

Ky objektiv, kërkon miratimin dhe implementimin e disa proceseve dhe ndryshimeve të brendshme, nga ana e KOSTT-it, për të mundësuar nisjen e shitjes së shërbimeve në tregun e telekomunikimeve. Prandaj, me qëllim të përsheptimit të proceseve, Banka Botërore për një afat të shkurtër ka angazhuar edhe një konsulent internacional. Synim i kësaj është të bëhet rishikimi i Planit të Biznesit dhe planeve operacionale, në mënyrë që KOSTT-it ti ofrojë inpute strategjike për të filluar me dhënien e shërbimeve të infrastrukturës të bazuar në fibra optike, të vlerësojë se çfarë plane operative duhet të merren në konsideratë në afat të shkurtër, dhe të ofrojë rekomandime.

Autor: **Nagip Sylja**
Menaxher i Sektorit të Telekomunikimit

Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 28 janar 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e dokumentit “Plani Zhvillimor I Transmisionit 2016-2025”. (V_777_2016)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur 28 janar 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim të i lejohet KOSTT-it derogimi në zbatimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut, Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit. (V_776_2016)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur 15 qershor 2015, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim të i lejohet KOSTT-it derogimi në zbatimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut, Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit. (V_739_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 10 prill 2015, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e dokumenteve për prokurimin e shërbimeve ndihmëse: Kushtet e përgjithshme për shërbimet ndihmëse, Shpjegime për kontratë të shërbimeve ndihmëse dhe udhëzimet tenderuese, Kriteret për vlerësimin e ofertave për shërbimet ndihmëse, Ftesë për tender për ofrimin e shërbimeve ndihmëse për vitin [yyyy] (V_731_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur 10 prill 2015, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim të i lejohet KOSTT-it derogimi në zbatimin e dispozitave të Rregullave të Tregut. (V_730_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur 10 prill, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim të aprovohet dokumenti “Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-Kufitare” (V_728_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 03 prill 2015, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e tarifave dhe ngarkesave që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) sh.a. (V_721_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 03 prill 2015, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) sh.a, përmes tarifave dhe ngarkesave për vitin relevant tarifor SHTE9. (V_717_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KQKO, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dokumentit “Kodi i Matjes” të KOSTT sh.a. (V_713_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KQKO, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dispozitave të Standardeve Elektrike të KOSTT sh.a. (V_712_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KQKO, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dokumentit “Kodi Operativ” të KOSTT sh.a. (V_711_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KQKO, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dokumentit “Kodi i Balancit” të KOSTT sh.a. (V_710_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KOSTT, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dispozitave të Kodit për Stacionet Gjeneruesetë Energjisë me Erë të KOSTT sh.a. (V_709_2015)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 20 shkurt 2015, në bazë të kërkesës të KOSTT, ka marrë vendim të aprovohen Procedurat e Rregullave të Tregut. (V_708_2015)